



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E LIBRIT DHE LEXIMIT
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, 12.12.2024

Nr 22 prot.

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA, DREJTOR EKZEKUTIV
Qendra "Res Publica", Tiranë

I nderuar Z. Matlija,

Në vijim të shkresës tuaj me Nr. 166/24 Prot datë 02.12.2024 me anë të së cilës kërkonti informacion për tu informuar në lidhje me:

- Kopje të pasqyrës financiare të buxhetit të Qendrës për secilin vit që prej themelimit të saj në vitin 2019 së bashku me zërat përkatës të këtij buxheti në lidhje me pagat për stafin e brendshëm, honorare për ekspertë të jashtëm dhe shërbime të tjera të marra nga palë të treta, aktivitete të organizuara nga QKLL, dhe për projekte botimi dhe përkthimi të mbështetura nga QKLL.

Ju bëjmë me dije se, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit është krijuar me Vendimin Nr. 24, datë 16.1.2019 "Për krijimin organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit", dhe struktura e QKLL është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 118 datë 11.09.2019 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit", informacione këto të publikuara në faqen e Webit të QKLL.

QKLL bazuar në misionin e saj ndjekjen dhe zbatimin e projekteve në fushën e librit, sipas programit qeverisës të ministrisë përgjegjëse për librin, duke synuar përhapjen e kulturës së leximit në të gjithë vendin, nxitjen e krijimtarisë, forcimin e rolit promovues dhe edukativ të bibliotekave dhe mbështetjen e projekteve për promovimin e letrave shqipe në tregun evropian dhe atë botëror, ushtron aktivitetin e saj duke u bazuar në Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe

Kulturën” i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”.

Viti i plotë buxhetor në të cilën ka filluar aktivitetin kulturor dhe financiar QKLL është viti 2020, ku në mars 2020 Qendra hapi dyert e saj. Buxheti ndër vite i QKLLi alokuar nga Ministria e Kulturës sot Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, është pasqyruar në tabelën e mëposhtë i ndarë në zërat për pagat, sigurimet, shpenzimet për mallra dhe shërbime, subvencione, projekte kulturore, dhe transferta.

Art.	Emertimi	Buxheti Viti 2020	Buxheti Viti 2021	Buxheti Viti 2022	Buxheti Viti 2023	Buxheti Viti 2024
600	Paga	6,154,898	8,122,524	8,206,761	10,445,661	11,821,959
601	Sigurime Shoqërore	1,026,205	1,352,218	1,342,189	1,725,482	2,134,834
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	999,764	1,146,639	996,520	3,398,045	1,000,000
603	Subvencione	12,998,624	-	-	-	-
604	Transferta Korente të Brendshme	-	11,996,797	16,084,351	16,994,198	14,495,000
605	Transferta Korente të Jashteme	-	-	603,955	609,997	
606	Transferta per Buxhete Familjare & Individuale	-	-	210,000	24,000	
Totali i Buxhetit		21,179,491	22,618,178	27,443,776	33,197,383	29,451,793

1. Pagat e punonjësve të institucionit tonë paguhen mbi bazën e Vendimit Nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagën të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar ku specialistët e klasës IV – 2 paguhen me pagën bazë 80,000 lekë, kurse specialistët e klasës IV- 3 paguhen 70,000 lekë.
Kurse në lidhje me punonjësit me arsim të mesëm bazohemi në Vendimin Nr. 422, datë 26.6.2024 “Për një ndryshim në vendimin Nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, sipas klasës I, III, dhe IV me paga bazë përkatësisht 44,000 lekë, 45,800 lekë, 46,500 lekë.
2. Në lidhje me honoraret për ekspertë të jashtëm pagesat e tyre kryhen duke u bazuar në Vendimet e Kolegjiut sipas aktiviteteve, Ligjin Nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë” për çdo shërbim. Bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Jurisë

së Fondit të Përkthimit Letrar, ku ne kemi pasur ekspertë të fushës, mbi cilësinë e përkthimeve, me Nr.177 Prot, date 13.03.2024, Kreu IV, Neni 9 “Ekspertët e jashtëm”, thuhet se “Emrat e përkthyesve dhe ekspertëve do të mbeten anonim”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Etleva Ramaliu
Specialiste,
Sektori i Shërbimeve Mbështetëse,
Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit